



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 tetor 2021
Nr. ref.:RK 1863/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI134/20

Parashtrues

Kompania e Sigurimeve “ZURICH Versicherungsveresin”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
E.Rev.nr.65/2019, të 19 shkurtit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryeytar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kompania e Sigurimeve “ZURICH Versicherungsveresin” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) përfaqësuar nga Visar Morina dhe Besnik Nikqi nga Shoqëria e Avokatisë “ICS Assistance L.L.C Prishtinë” me seli në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, E.Rev.nr.65/2019, të 19 shkurtit 2019 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ae.nr.52/2018, të 6 shtatorit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, III.EK.nr.187/16, të 29 janarit 2018.
3. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kishte pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 18 maj 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe nenin 21 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 24 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 2 tetor 2020, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe të njëjtit iu kërkuar që të dorëzojë dokumente shtesë dhe një kopje e kërkesës po ashtu iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të njëjtës iu kërkuar që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesë) që tregon ditën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 7 dhe 10 tetor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi nga një kopje të fletë-kthesës dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.52/2018, të 6 shtatorit 2019.

11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 30 qershor 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.
15. Më 8 shtator 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 11 gusht 2014 në Prizren kishte ndodhur një aksident komunikacioni me ç ‘rast ishin përfshirë personi M.Ll., i siguruar i Kompanisë së Sigurimeve “SIGMA” dhe personit A.P., i siguruar i parashtruesit të kërkesës. Deri tek aksidenti i komunikacionit kishte ardhur për shkak se i siguruari i Kompanisë së Sigurimeve “SIGMA” M.Ll. duke mos respektuar rregullat e komunikacionit kishte goditur veturën e të siguarit të parashtruesit të kërkesës, personit A.P.
17. Më 10 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Kompania e Sigurimeve “SIGMA” që të rimbursohet mbi bazën e subrogimit zhdëmtimi i paguar nga polica e sigurimit “auto-kasko”. Pasi që, parashtruesi i kërkesës dhe Kompania e Sigurimeve “SIGMA” nuk arritën marrëveshje për subrogim, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
18. Më 22 mars 2016, parashtruesi i kërkesës paraqitur padi kundër Kompanisë së Sigurimeve “SIGMA” në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke kërkuar që në emër të dëmit “kasko-regres” të pësuar nga aksidenti i komunikacionit të 11 gushtit 2014 që t’i paguhet shuma e përgjithshme prej 24.871.82 euro, me kamatë ligjore prej 12% duke filluar nga data 10 gusht 2015 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës Kompanisë së Sigurimeve “SIGMA” me seli në Prishtinë.

19. Pala e paditur Kompania e Sigurimeve "SIGMA" nuk kishte kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por kishte kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë, duke shtuar se lartësia e dëmit duhet të caktohet nga çmimi i tregut e jo sipas faturës së "serviseve" të shteteve të huaja meqenëse aksidenti ka ndodhur në Kosovë. Pala e paditur Kompanisë së Sigurimeve "SIGMA" po ashtu kishte theksuar se polica e sigurimit nuk ka mbulueshmëri në territorin e Kosovës.
20. Më 29 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykim [III.EK.nr.187/16] vendosi: (i) aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Sigma" me seli në Prishtinë, që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë në emër të shpërblimit dëmit-regresit, shumën e përgjithshme prej 24,871.82 euro me kamatë ligjore prej 12% duke llogaritur nga 10 gushti 2015 deri në pagesën definitive në afat prej shtatë (7) ditësh nën kërcënim të përmbarimit me detyrim; (iii) detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Sigma" që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore prej 2,629.10 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.
21. Gjykata Themelore, mes tjerash, arsyetoi: (i) duke iu referuar nenit 3 të "AVB" për kushtet e përgjithshme të sigurimeve në mënyrë shprehimore janë përmendur territorit e shteteve që janë përjashtuar nga siguri dhe aty nuk përmendet Kosova, prandaj rezulton se Kosova ka mbulueshmëri të sigurimit "auto-kasko"; (ii) bazuar në nenet 136.1 dhe 960.1 të LMD-së padia e parashtruesit të kërkesës është drejtë dhe e bazuar sepse ka paguar shpenzimet e të siguruarit të saj; (iii) bazuar në Rregulloren e BKQ-së për sigurimin nga auto-përgjegjësia, çmimi për dëmin mund të caktohet në bazë të faturës së në vendin e regjistrimit të mjetit motorik duke krahasuar riparimin me procesverbalin e dëmit; (iv) refuzohet propozimi i palës së paditur për caktimin e ekspertizës së re të makinerisë për shkak se asnjëra palë nuk e ka kontestuar objektivitetin dhe profesionalizmin e ekspertit; (v) pagesa e kamatës vjetor prej 12% caktohet bazuar në nenin 26 të ligjit për sigurimin nga autopërgjegjësia lidhur me nenin 382.2 të LMD-së.
22. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur Kompania e Sigurimeve "Sigma" paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, vendimin mbi kamatë si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovoj të bazuar, ta anuloj si joligjor Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [III.EK.nr.187/16] i 29 janarit 2018 dhe kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ta refuzoj në tërësi të pabazuar, apo aktgjykimin e goditur ta prish apo lëndën ta kthej në rigjykim në shkallë të parë. Parashtruesi i kërkesës në përgjigje ndaj ankesës kishte propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [III.EK.nr.187/16] i 29 janarit 2018.
23. Më 6 shtator 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykim [Ae.nr.52/2018] vendosi: (i) ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [III.EK.nr.187/16] i 29 janarit 2018, në pjesën aprovuese vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar ashtu që në shumën e gjykuar në lartësi prej 24.871.82 euro, detyrohet e paditura që parashtruesit të kërkesës t'ia paguaj kamatën sipas normës vjetore prej 8% duke filluar nga data 11 gusht 2015 deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit, ndërsa sa i përket pjesës tjetër refuzohet e pabazuar ankesa e të paditurës; dhe,

(ii) vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [III.EK.nr.187/16] i 29 janarit 2018.

24. Gjykata e Apelit e miratoi në përgjithësi aktgjykimin e kontestuar të gjykatës themelore duke e vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në ligj. Mirëpo, Gjykata e Apelit shpjegoi se aktgjykimi i kontestuar i gjykatës themelore karakterizohet nga zbatimi i gabuar i së drejtës materiale: (i) zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se kamata e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia; (ii) kamata e aplikuar nga gjykata e shkallës së parë është paraparë me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar; (iii) paragrafi 7 i nenit 26 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës për regresim borxhi, që është kamatë e paraparë vetëm për mos trajtim dhe rënie në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim; dhe, (iv) parashtruesi i kërkesës ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së por jo edhe kamatë të “kualifikuar” sipas dispozitave të zbatuara nga gjykata e shkallës së parë.
25. Më 8 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të procedurave kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që revizioni të aprovohet i bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë përkitazi me kamatëvonesën dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilën parashtruesit të kërkesës në shumën e gjykuar prej 24,871.82 euro i është pranuar kamatëvonesa prej 12% të interesit vjetor duke filluar nga data 10 gusht 2015 deri në pagesën definitive si dhe për shpenzimet shtesë përkitazi me ushtrimin e revizionit. Pala e paditur Kompania e Sigurimeve “SIGMA” kishte propozuar që revizioni i parashtruesit të kërkesës të refuzohet në tërësi i pabazuar.
26. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Supreme me Aktvendim [E.Rev.nr.65/2019] e hodhi të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ae.nr.52/2018] të 6 shtatorit 2019.
27. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) parashtruesi i kërkesës “godet” aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë vetëm përkitazi me normën e kamatës vjetore prej 8%, të gjykuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë duke filluar nga data 10 gusht 2015 deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës që janë krijuar me paraqitjen e revizionit; (ii) Gjykata Supreme në bazë të nenit 143.1 të LPK-së, me të njëjtin aktgjykim vendos për kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore; (iii) sipas dispozitës së nenit 30.2 të LPK-së, kërkesë aksesore konsiderohet kamata, shpenzimet e procedurës, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, të cilat nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesën kryesore; (iv) sipas nenit 211 të LPK-së revizioni mund të paraqitet kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ndërsa vlera e objektit të kontestit vetëm në bazë të kërkesës kryesore; (v) neni 30.2 i LPK-së normon se kërkesat aksesore nuk duhet të llogariten për

caktimin e vlerës së objektit të kontestit; (vi) shprehimisht kamata është e përjashtuar nga caktimi i vlerës së objektit të kontestit nëse paraqitet si kërkesë e pavarur; (vii) po ashtu bazuar në nenin 449 të LPK-së shpenzimet procedurale nuk merren parasysh në caktimin e vlerës së objektit të kontestit; (viii) revizioni i parashtruesit të kërkesës për kërkesat aksesore të kamatëvonesës dhe shpenzimeve procedurale është i palejuar, pasi që vlera e objektit të kontestit caktohet vetëm në bazë të kërkesës kryesore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në dëm të tij janë shkelur e drejta për qasje në gjykatë dhe e drejta për një vendim të arsyetuar si komponentë të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së.
30. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën për qasje në gjykatë dhe për një vendim të arsyetuar sepse nuk ka vlerësuar çështjen e uljes së kamatëvonesës nga Gjykata e Apelit nga 12 % në 8%. Parashtruesi më tej shton se është e rëndësishme që të ofroj arsyetimin e duhur përse kamatëvonesa është caktuar me 8% nga LMD-ja si “lex generalis” në vend të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia që parashikon 12% të normës vjetore të kamatëvonesës, si “lex specialis”.
31. Parashtruesi i kërkesës shton: *“Gjykata Kushtetuese duhet të dhe konstatojë nëse interpretimet dhe qëndrimet e Gjykatës Supreme përkitazi me dispozitat e nenit 30.2 dhe 211.2 të LPK, kishin për pasojë mohimin e të drejtës themelore të Parashtruesit të Kërkesës të qasjes në gjykatë në atë mënyrë dhe masë sa me këtë i mohohet e drejta në gjykim dhe e drejta për t’u dëgjuar.”*
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon: (i) neni 30 i LPK-së është vetëm në funksion të përcaktimit të vlerës së objektit të kontestit në përgjithësi, por në asnjë mënyrë në rastet kur kërkesëpadia lidhur me kamatën është objekt i vetëm i shqyrtimit gjyqësor; (ii) interpretimi “gramatikor” i nenit 30.2 të LPK-së nga Gjykata Supreme rezulton jo logjik me konkluzion se kontesti për kërkesëpadinë për kamatat është pavlerë fare; (iii) në padinë e datës 22 mars 2016 kamatëvonesa ishte përfshirë në kërkesëpadi së bashku me kërkesën për subrogim çfarë njëkohësisht është trajtuar si e tillë edhe me aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët; dhe, se (iv) “kamata ndan fatin e njëjtë të detyrimit kryesor” prandaj mos shqyrtimi i kësaj çështjeje rezulton me shkelje të qasjes në gjykatë.
33. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton: *“Parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme me vendimin e kontestuar me këtë Kërkesë si pasojë e mungesës së arsyetimit adekuat (me referencë dhe interpretim të gabuar të paragrafit 2 të nenit 30 të LPK) ka mohuar të drejtën e shqyrtimit*

gjyqësor të kërkesëpadisë në tërësi, respektivisht pamundëson që me revizion të trajtohet pretendimi për zbatim të gabuar të së drejtës materiale në pjesën e kërkesëpadisë që i referohet kamatëvonesës.”

34. Për të mbështetur pretendimet për të drejtën për një vendim të arsyetuar, parashtruesi i referohet rasteve të Gjykatës siç janë KI72/12, KI22/16, KI43/16, KI97/16 dhe KI87/18 si dhe rasteve nga jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ-së siç janë Tatashvilli kundër Rusisë, Van der Hurk kundër Holandës, Hiro Balani kundër Finlandës, etj.
35. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon: “[...] dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë vendime të arsyetuara (dhe në rastin konkret refuzimi arbitrar i revizionit të parashtruar nga Parashtruesi) ka cenuar edhe të drejtën e pronës të përcaktuar me nenin 46 të Republikës së Kosovës.”
36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se bazuar në praktikën e GJEDNJ-së lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrotjtja e pronës], ai ka pritje legjitime bazuar në të drejtën për subrogim për të gëzuar dëmshpërblim të kamatës prej 12% të përcaktuar me ligj.
37. Sipas parashtruesit të kërkesës, refuzimi arbitrar i revizionit po ashtu bie në fushëveprimin e nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 [Mbrotjtja e pronës], të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës shton se mohimi i të drejtës në subrogim dhe kamatëvonesë për shkak të vendimit të paarsyetuar përbën ndërhyrje të qartë të së drejtës në pronë siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
38. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që të konstatohet cenimi i të drejtës për gjykim të drejtë konform neneve 31 dhe 46 të Kushtetutës; (ii) që pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme [E.Rev.nr.65/2019] të 19 shkurtit 2020 për shkak të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së; dhe, (iii) çështjen ta kthej për rishqyrtim.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE NR. 04/L-077

*Neni 281
Subrogimi ligjor*

Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.

NËNKREU 3

VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA

Neni 382
Kamatëvonesa

1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.
2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

NËNKREU 6

**KALIMI I TË DREJTAVE TË SIGURUARIT NDAJ PERSONIT
PËRGJEGJËS NË SIGURUESIN (SUBROGIMI)**

Neni 960
Subrogimi

1. Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të sigurvearit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.
2. Në qoftë se për faj të të sigurvearit është bërë i pamundur ky kalim i të drejtave në sigurues tërësisht ose pjesërisht, siguruesi shkarkohet në masën përkatëse nga detyrimi i vet ndaj të sigurvearit.
3. Kalimi i të drejtave nga i siguruari në sigurues nuk mund të jetë në dëm të të sigurvearit, kështu që në qoftë se shpërblimi të cilin e ka marrë i siguruari nga siguruesi për cilindo shkak qoftë është më i vogël nga sa është dëmi që ka pësuar, i siguruari ka të drejtë që prej pasurisë së personit përgjegjës t'i paguhet mbetja e kompensimit përpara kërkesës së siguruesit në bazë të të drejtave që janë kaluar në të.
4. Përjashtimisht nga rregullat mbi kalimin e të drejtave të të sigurvearit në siguruesin, këto të drejta nuk kalohen në siguruesin, në qoftë se dëmin e ka shkaktuar personi në gjini në vijë të drejtë me të sigurvearin, ose personi për sjelljet e të cilit përgjigjet siguruesi apo i cili bashkëjeton me të në të njëjtën ekonomi shtëpiake, ose personi që është punëtor i të sigurvearit, përveç nëse këta persona e kanë shkaktuar dëmin me dashje.
5. Në qoftë se dikush nga personat e përmendur në paragrafin paraprak ka qenë i siguruar nga përgjegjësia, siguruesi mund të kërkojë nga siguruesi i tij kompensimin e shumës që i ka paguar të sigurvearit.

**LIGJI PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA
AUTOPËRGJEGJËSIA NR. 04/L-018**

Neni 26
Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:

1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;

1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëshmipërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Ligji për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006

Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

Neni 30

30.1 Padiësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.

30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera ankesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbejnë kërkesë kryesore.

A K T G J Y K I M I

Neni 143

143.1 Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.

143.2 Në qoftë se me një padi janë përfshirë disa kërkesëpadi, gjykata, zakonisht vendosë për të gjitha me një aktgjykim të vetëm.

143.3 Në qoftë se gjykata i ka bashkuar disa procedime me qëllim të shqyrtimit të përbashkët të çështjeve, kurse për vendosje përfundimtare është pjekur vetëm njëra nga to, mund të jepet aktgjykimi vetëm për çështjen e tillë.

Neni 221

Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me, aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 218 i këtij ligji).

Neni 230

Në procedurën sipas revizionit kundër aktvendimit në mënyrë adekuate aplikohen dispozitat e këtij ligji mbi revizionin kundër aktgjykimit.

SHPENZIMET PROCEDURALE

1) Përbërja e shpenzimeve procedurale

Neni 449

449.1 Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor.

449.2 Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

41. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

42. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë. (Shih, rastet e Gjykatës KI118/18, Parashtrues, *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 29; KI32/20, Parashtrues, *Xhevat Meha*, Aktvendim i 11 nëntorit 2020, paragrafi 34; dhe KI41/09, me parashtrues, *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14). Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [E.Rev.nr.65/2019] të 19 shkurtit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
43. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret nga neni 48 i Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
44. Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2, i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

45. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse Gjykata Supreme nuk ka adresuar dhe arsyetuar kërkesëpadinë e tij në tërësi me ç ‘rast ka shkelur dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të drejtën për qasje në gjykatë.
46. Gjykata vlerëson se kërkesa nën shqyrtim, do të vlerësohet bazuar në pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës: (i) përkitazi me të drejtën e tij për një vendim të arsyetuar; (ii) përkitazi me të drejtën e tij për qasje në gjykatë; dhe, (iii) përkitazi me të drejtën e tij për mbrojtje të pronës.
47. Gjykata në vijim, do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Lidhur me pretendimin për mos arsyetim të vendimit gjyqësor

48. Gjykata thekson se në kontekst të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata Supreme ka shkelur për një vendim të arsyetuar sepse nuk ka vlerësuar çështjen e uljes së kamatëvonesës nga Gjykata e Apelit nga 12 % në 8% [...] është e rëndësishme që të ofroj arsyetimin e duhur përse kamatëvonesa është caktuar me 8% nga LMD-ja si “lex generalis” në vend të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia që parashikon 12% të normës vjetore të kamatëvonesës, si “lex specialis”.*
49. Ndërlidhur me pretendimin e lartpërmendur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vë në spikamë konstatimet relevante të Gjykatës Supreme: (i) parashtruesi i kërkesës “godet” aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë vetëm përkitazi me normën e kamatës vjetore prej 8%, të gjykuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë duke filluar nga data 10 gusht 2015 deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës që janë krijuar me paraqitjen e revizionit; (ii) Gjykata Supreme në bazë të nenit 143.1 të LPK-së, me të njëjtin aktgjykim vendos për kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore; (iii) sipas dispozitës së nenit 30.2 të LPK-së, kërkesë aksesore konsiderohet kamata, shpenzimet e procedurës, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, të cilat nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesën kryesore; (iv) sipas nenit 211 të LPK-së revizioni mund të paraqitet kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ndërsa vlera e objektit të kontestit vetëm në bazë të kërkesës kryesore; (v) neni 30.2 i LPK-së normon se kërkesat aksesore nuk duhet të llogariten për caktimin e vlerës së objektit të kontestit; (vi) shprehimisht kamata është e përjashtuar nga caktimi i vlerës së objektit të kontestit nëse paraqitet si kërkesë e pavarur; (vii) po ashtu bazuar në nenin 449 të LPK-së shpenzimet procedurale nuk merren parasysh në caktimin e vlerës së objektit të kontestit; (viii) revizioni i parashtruesit të kërkesës për kërkesat aksesore të kamatëvonesës dhe shpenzimeve procedurale është i palejuar, pasi që vlera e objektit të kontestit caktohet vetëm në bazë të kërkesës kryesore.
50. Në kontekst të arsyetimit të Gjykatës Supreme, Gjykata i referohet nenit 30 të LPK-së, që parashikon:
- “30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore.*
- 30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore”.*
51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesës relevante të arsyetimit të dhënë nga Gjykata Supreme: *“Sipas nenit 211 të LPK-së, revizioni mund të paraqitet kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa vlera e objektit të kontestit caktohet vetëm në bazë të kërkesës kryesore. Kërkesat aksesore që kanë të bëjnë me kamatën, shpenzimet e procedurës nuk merren parasysh me*

rastin e caktimit të vlerës së objektit të kontestit, për faktin se, paragrafi 2 i nenit 30 të LPK-së, normon se kërkesat tjera aksesore nuk duhet të llogariten për caktimin e vlerës së objektit të kontestit. Shprehimisht kamata është përjashtuar nga caktimi i vlerës së objektit të kontestit, nëse është paraqitur si kërkesë e pavarur [...] kjo Gjykatë vlerëson se revizioni i paditësës paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, për kërkesat aksesore për pagimin e kamatëvonesës dhe shpenzimeve të procedurës është i palejuar, pasi që vlera e objektit të kontestit në revizion caktohet vetëm në bazë të kërkesës kryesore”.

52. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka dhënë bazën ligjore me arsyetim të mjaftueshëm përse *“nuk ka vlerësuar çështjen e uljes së kamatëvonesës nga Gjykata e Apelit nga 12 % në 8%.”*
53. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i mos arsyetimit të vendimit të Gjykatës Supreme, i cili ndërlidhet me çështjen e interpretimit dhe zbatimit të nenit 30, paragrafi 2 i LPK-së, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i “dispozitave ligjore” nga Gjykata Supreme, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtuesin e kërkesës, apo se si procedura para Gjykatës Supreme mund të mos ketë qenë e drejtë apo edhe të ketë qenë arbitrare (shih rastin e Gjykatës nr. KI87/20, *Parashtrues, “SUVA” Rechtsabteilung*, Aktvendim për Papranueshmëri i 26 marsit 2021, paragrafi 70).
54. Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë dhe mbështesë pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(ii) Lidhur me pretendimin për mohim të qasjes në Gjykatë

55. Gjykata vëren se sa i përket mohimit të së drejtës për qasje në gjykatë, parashtuesi i kërkesës pretendon: *“Gjykata Kushtetuese duhet të konstatojë nëse interpretimet dhe qëndrimet e Gjykatës Supreme përkitazi me dispozitat e nenit 30.2 dhe 211.2 të LPK, kishin për pasojë mohimin e të drejtës themelore të Parashtruesit të Kërkesës të qasjes në gjykatë në atë mënyrë dhe masë sa me këtë i mohohet e drejta në gjykim dhe e drejta për t’u dëgjuar.”*
56. Nga sa më sipër, Gjykata duke u mbështetur në jurisprudencën e saj por edhe të GJEDNJ-së ka theksuar se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së garantojnë të drejtën për qasje në gjykatë çka nënkupton të drejtën për të filluar procedurat dhe për zgjidhje efektive të rastit para gjykatave, si komponentë thelbësore të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të kufizohet; këto kufizime janë të lejuara pasi që e drejta për qasje në gjykatë kërkon që të rregullohet nga shtetet veç e veç. Në këtë kuptim, shtetet gëzojnë një margjinë të vlerësimit dhe vendimi përfundimtar për respektimin e kërkesave për qasje në drejtësi i takon Gjykatës (shih rastet e Gjykatës KI133/17 *Parashtrues Ali Gashi*, Aktvendim për

Papranueshmëri i 29 korrikut 2019, paragrafi 52 dhe referencat e përmendura aty; KI87/20, *Parashtrues, "SUVA" Rechtsabteilung*, cituar më lart, paragrafi 72; dhe, po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 tetorit 1998, paragrafi 147; *Prince Hans-Adam i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 44).

57. Në kontekst të pretendimit për mohim të qasjes në gjykatë, Gjykata vëren se pas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit pjesërisht ishte ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore vetëm sa i përket lartësisë së kamatës, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme me pretendimin për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga Gjykata e Apelit, e cila kishte përcaktuar lartësinë e kamatës prej 8% duke u bazuar në nenin 382.2 të LMD-së. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme revizionin e parashtruesit të kërkesës e kishte hedhur poshtë të palejuar duke u mbështetur në nenet 30.2 dhe 211.2 të LPK-së.
58. Gjykata duke u mbështetur në praktikën e saj por edhe të GJEDNJ-së thekson se megjithëse secili ka të drejtë për të përdorur mjetet juridike kundër vendimeve administrative dhe gjyqësore, Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk garanton të drejtën e ankesës nëse nuk parashikohet me legjislacionin vendor. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, përderisa me kërkesën e tij për revizion, e cila i referohet çështjes së lartësisë së kamatës, Gjykata Supreme ka konstatuar se e njëjta bazuar në dispozitat përkatëse të LPK-së ishte e palejuar (shih rastin e Gjykatës KI87/20, *Parashtrues, "SUVA" Rechtsabteilung*, cituar më lart, paragrafi 75; po ashtu shih rastin e GJEDNJ-së *Darnay kundër Hungarisë*, Vendim i 16 prillit 1998).
59. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë dhe mbështesë pretendimin për shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

II. Pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 të KEDNJ-së

60. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se: "[...] dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë vendime të arsyetuara dhe në rastin konkret refuzimi arbitrar i revizionit të parashtruar nga Parashtruesi" ka cenuar edhe të drejtën e pronës të përcaktuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës thekson se në rastin e tij "mohimi i të drejtës në subrogim dhe kamatëvonesë për shkak të vendimit të paarsyetuar përbën ndërhyrje të qartë të së drejtës në pronë" siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
61. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës për pretendimin e tij për shkelje të nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në mënyrë specifike e ndërlidhë me pretendimin për shkelje të së

drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mos arsyetimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Supreme. Gjykata po ashtu rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar dhe për qasje në gjykatë, janë refuzuar si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

62. Gjykata konstaton se edhe pretendimi i parashtruesi i kërkesës për shkelje të nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
63. Në përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse:
 - I. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, që ndërlidhen me pretendimet (i) për mos arsyetim të vendimit gjyqësor; (ii) për shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë janë të papranueshme sepse janë qartazi të pabazuara, siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
 - II. Pretendimi për shkelje të së drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është i papranueshëm sepse është qartazi i pabazuar, siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Besa Caka-Nimani